



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Ministria e Financave –Ministarstvo za Finansije-Ministry of Finance
Agjencia Qendrore e Prokurimit/Centralna Agjencia Nabavka / Central Procurement Agency

Datë/A:	04 .04.2016
Për/Za/To:	Autoritetet Kontraktuese
CC:	Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP)
Nga/Od/From:	Mursel Racaj, Drejtor Ekzekutiv i Agjencisë Qendrore të Prokurimit
Tema/Subjekat/Subjekt:	Informim lidhur me zhvillimin e Prokurimeve Qendrore

Të nderuar,

Ju informojmë se Agjencia Qendrore e Prokurimit me datën 26.01.2016, në bazë të Ligjit të Prokurimit Publik, neni 95 pika 2 ka dorëzuar listën e artikujve të përdorimit të përbashkët për Prokurime Qendrore për vitin fiskal 2016 në Ministrinë e Financave. Qeveria, sipas propozimit të Ministrisë së Financave, në mbledhjen e saj të fundit ka aprovuar Udhëzimin Administrativ Nr.05/2016 për artikujt e përdorimit të përbashkët, prokurimi i të cilave i është caktuar AQP-së. Autoritetet Kontraktuese që gjenden në listën e publikuar në uebfaqen e KRPP-së (www.krpp.rks-gov.net) dhe në uebfaqen e AQP-së (www.aqp.rks-gov.net) nuk mund të zhvillojnë prokurimet për artikujt e listës së aprovuar nga Qeveria e Kosovës sipas nenit 95, paragrafi 2 i Ligjit Prokurimit Publik të Republikës së Kosovës Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092. Kjo listë dhe çdo ndryshim i saj duhet të publikohen në media dhe të shpallen në faqen e internetit të KRPP-së, të përcaktuar në nën paragrafin 2.10 të paragrafit 2 të nenit 87 të këtij ligji.

Në bazë të planifikimeve përfundimtare të dorëzuara në AQP nga Autoritetet Kontraktuese për vitin fiskal 2016, AQP propozon që për vitin fiskal 2016 të udhëheq 2 (dy) kategori të aktiviteteve të prokurimit të centralizuara si në vijim:

- I. Aktivitetet e prokurimit të centralizuara në **nivel qendror**
- II. Aktivitetet e prokurimit të centralizuara në **nivel lokal**.

Obligohen të gjitha Autoritetet Kontraktuese që të ofrojnë bashkëpunimin e tyre me zyrtarët përgjegjës për prokurimet qendrore të AQP-së, për ofrimin e të dhënave për zhvillimin e procedurave të prokurimit qendror qoftë në nivelin qendror apo nivelin lokal.

Shtojcë: Udhëzim Administrativ QRK Nr. 05/ 2016 për zbatimin e procedurave qendrore të prokurimit publik

Me respekt